



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të nenit 50, pika 3 të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm të kualifikuar në kryerjen e studimeve në fushën ligjore, sociale etj.

TERMAT E REFERENCËS

Qëllimi

Referuar Planit të Veprimit, për vitin 2021, është parashikuar miratimi i akteve nënligjore:

1. Rishikimi i rregullores “Për kriteret për përcaktimin e planit të renditjes dhe procedurën e caktimit të dhënies së numrit identifikues për ofruesit e shërbimit mediatic audio dhe/ose audioviziv”;
2. Rregullore “Për detyrimin e mbartjes së programeve kombëtare (Must Carry)”.

Këto dy akte janë me ndikim të ndjeshëm në veprimtarinë e subjekteve audiovizive, prandaj kërkohet ekspertizë e veçantë, me qëllim studimin dhe marrjen e praktikave më të mira të vendeve të rajonit e më gjerë, për draftimin e 2 akteve nënligjore, në zbatim të detyrimeve të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Detyrat

- Të kryejë analizë të kuadrit nënligjor në disa vende të rajonit, lidhur me rregullimin në këto vende të rregullave must carry, detyrimet e mbartjes, si dhe për renditjen e shërbimeve programore. Pas kësaj analize, paraqitjen e rekomandimeve për marrjen e praktikave më të mira në këto vende, gjatë hartimit të 2 akteve nënligjore.
- Të përgatisë rekomandimet për AMA-n me qëllim draftimin e tyre në akte nënligjore.
- Të asistojë stafin e AMA-s gjatë hartimit të 2 projektakteve.

Periudha e zbatimit të detyrave

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 3 (tre) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm

1. Të ketë eksperiencë në kryerjen e studimeve në fushën ligjore, sociale, etj.
2. Të ketë kryer punë të ngjashme;
3. Të jetë shtetas/e shqiptar.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

1. Kopje të noterizuar të Diplomës (preferohet Shkenca Juridike);
2. Dokumentacion që vërteton punë të ngjashme (kontrata, vërtetime, etj).
3. Jetëshkrim/CV;
4. Kopje ID/Pasaportë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

1. Eksperienca në punë: 70 pikë
2. Jetëshkrimi: 30 pikë

APLIKIMET MBYLLEN NË DATËN 23.06.2021, ora 11:00

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda këtij afati në adresën e Autoritetit të Mediave Audiovizive: “Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, 1010, Tiranë.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 09.06.2021